



7823

12.07.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**MARRËVESHJE**

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Sot, më datë 16.03.2022, Palët e mëposhtme:

**Këshilli Kombëtar i Territorit**, përfaqësuar nga Kryeministri dhe Kryetari i KKT  
Z. Edi Rama

dhe

**Bashkia Vlorë**, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Dritan Leli

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar dhe Lejes Zhvillimore të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr.31, datë 16.03.2022, për objektin: “Kompleks me funksion shërbim hoteleri dhe shtëpi të dyta”, me vendndodhje në Bashkinë Vlorë, bien dakord si më poshtë:

**NENI 1**  
**OBJEKTI**

- 1.1 Objekti i kësaj marrëveshje është delegimi i kompetencave Bashkisë Vlorë për kryerjen e procedurave përkatëse ligjore, në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, në lidhje me ndërtimin e objektit: “Kompleks me funksion shërbim hoteleri dhe shtëpi të dyta”, me vendndodhje në



Bashkinë Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Imeraj & AG Construction” sh.p.k, sipas Lejes Zhvillimore përkatëse, të miratuar me vendimin e KKT-së Nr.31, datë 16.03.2022.

## **NENI 2 KOHËZGJATJA**

- 2.1 Kompetencat objekt i kësaj Marrëveshjeje do të ushtrohen nga Bashkia Vlorë, nga data e paraqitjes së aplikimit fillestar të subjektit zhvillues për Leje Ndërtimi, deri në datën e lëshimit të Çertifikatës së Përdorimit.

## **NENI 3 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE**

- 3.1 Këshilli Kombëtar i Territorit ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:
- i. Vënie në dispozicion të Bashkisë Vlorë të Lejes së Zhvillimit të miratuar me vendimin e KKT-së Nr.31, datë 16.03.2022, për objektin: “Kompleks me funksion shërbim hoteleri dhe shtëpi të dyta”, me vendndodhje në Bashkinë Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Imeraj & AG Construction” sh.p.k,
- dhe
- ii. Hartën e Planvendosjes së Strukturave që shoqëron këtë Vendim.
- 3.2 Bashkia Vlorë ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:
- i. Kryerjen e të gjitha procedurave administrative/ligjore, sipas përcaktimeve të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, për objektin: “Kompleks me funksion shërbim hoteleri dhe shtëpi të dyta”, me vendndodhje në Bashkinë Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Imeraj & AG Construction” sh.p.k.
  - ii. Shqyrtimin, verifikimin dhe vlerësimin e dokumentacionit përkatës teknik; të dokumenteve që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në këtë zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta, si dhe të çdo akti/dokumenti tjetër



ligjor, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

- iii. Miratimin dhe lëshimin e akteve/dokumenteve të poshtëshënuara, për objektin: “Kompleks me funksion shërbim hoteleri dhe shtëpi të dyta”, me vendndodhje në Bashkinë Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Imeraj & AG Construction” sh.p.k, sipas Lejes Zhvillimore përkatëse, të miratuar me vendimin e KKT-së Nr.31, datë 16.03.2022:
- Leje Ndërtimi;
  - Certifikatë Përdorimi.

#### **NENI 4 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

- 4.1 Palët do t'i zgjidhin të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje me mirëkuptim ndërmjet tyre.

#### **NENI 5 GJUHA E MARRËVESHJES**

- 5.1 Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe me vlerë të njëjtë.

#### **NENI 6 EFEKTET JURIDIKE DHE PUBLIKIMI**

- 6.1 Palët bien dakord se efektet juridike të kësaj Marrëveshjeje do të fillojnë në momentin e nënshkrimit të saj.
- 6.2 Kjo Marrëveshje publikohet në Fletoren Zyrtare.

#### **PALËT**

**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

Përfaqësuar nga,  
**Z. EDI RAMA**



**BASHKIA VLORE**

Përfaqësuar nga,  
**Z. DRITAN LELI**

